




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 107/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë kundër vendimit të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Rregullimi i parkut të qytetit- Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit : 632-18-052-521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjakovë” më datën 02.04.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i parkut të qytetit- Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit : 632-18-052-521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- KK-Gjakovë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Rregullimi i parkut të qytetit- Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit : 632-18-052-521 AK- KK-Gjakovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:25.06.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:17.07.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit e pa suksesshëm: 25.02.2019

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës: 25.02.2019

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, operatori ekonomik“D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë me dt: 27.02.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues- “KK-Gjakovë” me datën 04.03.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:“D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me13.03.2019 me nr. 107/19,kundër vendimit të AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Rregullimi i parkut të qytetit- Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit : 632-18-052-521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjakovë” duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,51,52,56,59,60,72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.03.2019ka autorizuar

ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:26.03.2019, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "D&T Group shpk & Horn & Co Kosovashpk & NP Inovashpk"-Gjakovënë finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se janë të dëmtuar dhe se kompanitë e tërhequra janë të gatshme për implementin, Eksperti sqaron se nga grupi i OE "D&T GROUP SHPK" & "HORN & CO. KOSOVA SHPK" & "NP INOVA SHPK" me datë 16.11.2018 është tërhequr nga grupi anëtar "NP INOVA SHPK" dhe për këtë ka njoftuar përmes postës elektronike OSHP, AK dhe dy anëtarët e tjerë të grupit me dokumentin me titull "Vendim" ku ndër të tjera shkruan "Ne kompania jonë INOVA SHPK me nr. biznesi 70086064 ju njoftojmë se kemi marr vendim që të tërhiqemi nga gara për këtë projekt konkretisht nga grupi "D&T GROUP SHPK" & "HORN & CO. KOSOVA SHPK" & "NP INOVA SHPK". Në lidhje me këtë vendim të kompanisë tonë, do të jenë të informuar edhe lideri i grupit D&T Group sh.p.k dhe anëtar i dytë i grupit Horn & Co Kosova sh.p.k. Andaj në bazë të kësaj, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që nëni 27.5 i RrUOPP thotë "Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet".

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një listë me titull "Lista e stafit profesional" pas dorëzimit, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që kjo listë është dorëzuar së bashku me ofertën nga ana e OE.

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është falsifikuar nënshkrimi në kontratën mbi vepër për inxhinierin Avdyl Berisha dhe inxhinierin Albert Margegaj, Eksperti sqaron se nuk është në kompetencë të tij që të përcaktoj një gjë të tillë dhe sqaron se për inxhinierin Avdyl Berisha është ofruar dokumenti me titull "Kontratë pune mbi vepër" e nënshkruar nga të dy palët kontraktuese dhe e vë në mes të inxhinierit dhe MARISA SHPK e datës 10.07.2018 dhe për inxhinierin Albert Margegaj dokumenti me titull "Kontratë pune mbi vepër" e nënshkruar nga të dy palët kontraktuese dhe e vë në mes të inxhinierit dhe MARISA SHPK e datës 07.07.2018.

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se inxhinierët Albert Margegaj dhe Avdyl Berisha nuk figurojnë në listën e cila është dorëzuar me ofertë, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi

që këta të dy inxhinierë janë në dokumentin me titull "Lista e stafit profesional" që është dorëzuar së bashku me ofertë.

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se kompania "BENI" ka kërkuar qasje në dokumentacionin e "MARISA SHPK & GËRLICA SHPK", Eksperti sqaron se OE "BENI" është pjesë e ofertave të këtij tenderi mirëpo nuk ka bërë ankesë andaj mund të thuhet se kjo pikë e ankesës është e paqartë.

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriteret administrative në dosje të tenderit përkatësisht nuk ka paraqitur a) "Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i inxhinierisë së ndërtimit drejtimi konstruktiv" por ka paraqitur bachelor dhe se nuk ka paraqitur c) "Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose master i inxhinierisë elektrike", Eksperti sqaron se kjo pikë është paqëndrueshme dhe se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "a) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i inxhinierisë së ndërtimit - drejtimi konstruktiv" dhe "c) një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose master i inxhinierisë elektrike i dhe kompjuterike" dhe si dëshmi është kërkuar "diploma" dhe se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar diplomën e Albert Margegaj për inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv dhe ka ofruar diplomën e Avdyl Berisha për inxhinier të diplomuar të elektroteknikës.

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur pajisje teknike sipas kërkesës së dosjes së tenderit të FTD, Eksperti sqaron se OE ankues nuk ka qartësuar se cilën nga pajisjet nuk është ofruar dhe sqaron se në fazën e vlerësimit nga ana e AK i është kërkuar sqarime shtesë OE të rekomanduar për kontratë për disa nga pajisjet dhe OE ka ofruar brenda afatit kohor sqarimet e dhëna dhe se në ofertë është ofruar dokumenti me titull "Lista e mjeteve" nga anëtari i grupit "GËRLICA COMPANY SHPK" me gjithsej 49 mjete/pajisje për të cilat janë ofruar një sërë dokumentesh tjera përcjellëse siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e sipër përmendur. 1 dhe 2) dhe të mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënie.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.03.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues senukpajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.03.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 02.03.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-së ankues z. Kusari deklaroj: Ne kemi bere një ankese dhe qëndrojmë pran ankesës. Pasi që ne mendojmë që janë shkelur ligji i prokurimit 04L-42 neni 1 paragrafi 1 dhe 3 neni 6 par 2. neni 7 par 1 dhe 7 neni 51 neni 52 par 4 neni 56, ne kemi bazën tone te forte pasi që OE i rekomanduar për kontrate gjate vlerësimeve te me hershme është shpallur i papërgjegjshëm pasi që në sqarimet te kërkuara në AK me dt 01.08.2018 OE i rekomanduar ka sjellë shtese një liste te stafit profesional te cilën ju dorëzoj panelit e cila nuk ka qenë ne dosjet te tenderit dhe kjo është ne kundërshtim me LPP-në. Ne kemi verifikuar se edhe inxhinieri AlbertMark Gegaj dhe Avdyl Berisha janë fiktiv me marrëveshje fiktive te futur ne DT pa pëlqimin e tyre me çka e kemi edhe një deklaratë nga Inxhinieri i elektrikes Avdyl Berisha te cilën e ka dhen para noterit dhe i dorëzoj panelit kopjen, Deklaron që ju ka keqpërdor firma dhe nuk është pjese e kësaj marrëveshje.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesit të AK-së z. Gutaj deklaroj: Ne si AK pas vendimit te OSHP për anulim te kontratës dhe kthim ne rivlerësim na është ardhur njoftim nga 2 OE që janë hequr nga konzorciumi i "Nova" SHPK dhe HORN KOSOVA SHPK pasi këtyre njoftimeve që janë tërhequr nga konzorciumi nuk ka pas baze që te vazhdohet me OE dhe si AK kemi shpërblyer OE "MARISA SHPK dhe GERLICA".

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja shqyrtuese znj. Prebreza deklaroj: Për pos atyre që kam cekur ne ekspertize dua te shtoj se Marrëveshja e inxhinierit Avdyl Berisha nuk ka qenë ne dokumentacionin e cekur ne fjale dhe dua ta përmend përsëripërgjigjën e pretendimit nr 1 që është e shkruar ne ekspertize që njeri nga 3 anëtarët me dt 16.11.2018 është tërhequr nga grupi dhe ne këto raste tenderi duhet te anulohet.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Pajtohemi me mendimin e ekspertës Kërkojmë që ankesa e OE te refuzohet dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: kërkesa e jone te aprovohet dhe lënda te kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se janë të dëmtuar dhe se kompanitë e tërhequra janë të gatshme për implementim. Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i OE “D&T GROUP SHPK” & “HORN & CO. KOSOVA SHPK” & “NP INOVA SHPK” me datë 16.11.2018 është tërhequr nga grupi anëtar “NP INOVA SHPK” dhe për këtëka njoftuar përmes postës elektronike OSHP, AK dhe dy anëtarët e tjerë të grupit me dokumentin me titull “Vendim” ku ndër të tjera shkruan “Ne kompania jonë INOVA SHPK me nr. biznesi 70086064 ju njoftojmë se kemi marr vendim që të tërhiqemi nga gara për këtë projekt konkretisht nga grupi “D&T GROUP SHPK” & “HORN & CO. KOSOVA SHPK” & “NP INOVA SHPK”. Në lidhje me këtë vendim të kompanisë tonë, do të jenë të informuar edhe lideri i grupit D&T Groupsh.p.k dhe anëtar i dytë i grupit Horn&Co Kosova sh.p.k. Andaj duke u bazuar ne sqarimet e dhëna si me lart Paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik ne fjale është i pa përgjegjshëm sepse neni 27.5 i RrUOPP thotë “Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet”. Andaj Paneli shqyrtues konstaton se duke pas parasysh sqarimet e dhëna si më lart ku vërtetohet fakti se OE ankues nuk është i përgjegjshëm prandaj konstatohet se OE ankues duhet te diskualifikohet edhe si palë pa interes në këtë aktivitet te prokurimit sepse i njëjti operator ekonomik nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktivitetit të prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 4 paragrafi 1 pika 26 të LPP-së në te cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një listë me titull “Lista e stafit profesional” pas dorëzimit. Paneli Shqyrtues duke u bazuar edhe ne sqarimet e dhëna nga Eksperti shqyrtues sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që kjo listë është dorëzuar së bashku me ofertën nga ana e OE.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është falsifikuar nënshkrimi në kontratën mbi vepër për inxhinierin Avdyl Berisha dhe inxhinierin Albert Margegaj. Paneli shqyrtues sqaron se për inxhinierin

Avdyl Berisha është ofruar dokumenti me titull "Kontratë pune mbi vepër" e nënshkruar nga të dy palët kontraktuese dhe e vulosur në mes të inxhinierit dhe OE "MARISA SHPK e datës 10.07.2018 dhe për inxhinierin Albert Margegaj dokumenti me titull "Kontratë pune mbi vepër" e nënshkruar nga të dy palët kontraktuese dhe e vulosur në mes të inxhinierit dhe OE "MARISA" SHPK e datës 07.07.2018. Paneli shqyrtues sqaron se në nenin 56.3 i LPP-së thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ne rastin konkret vërtetohet fakti se OE i rekomanduar përdhënie të kontratës ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për Kontrate, ndërsa lidhur me dyshimin rreth falsifikimit të dëshmive të cekura si me lart Paneli shqyrtues ju sqaron se operatori ekonomik ankues duhet të drejtohet institucioneve kompetente për të vërtetuar dyshimin e tij sepse OSHP nuk ka asnjë mundësi teknike për një verifikim të tillë.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se inxhinierët Albert Margegaj dhe Avdyl Berisha nuk figurojnë në listën e cila është dorëzuar më ofertë. Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e Ekspertit shqyrtues konstaton se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që këta të dy inxhinierë janë në dokumentin me titull "Lista e stafit profesional" që është dorëzuar së bashku me ofertë.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se kompania "BENI" ka kërkuar qasje në dokumentacionin e "MARISA SHPK & GËRLICA SHPK". Paneli shqyrtues konstaton se konstatimet dhe vlerësimet nga ana e panelit merren vetëm për pretendimet ankimore të OE ankues. Edhe pse OE "BENI" është pjesë e ofertave të këtij tenderi sqarojmë se i njëjti OE nuk ka bërë ankesë dhe lirisht mund të thuhet se OE në fjalë nuk është pale me interes në aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriteret administrative në dosje të tenderit përkatësisht nuk ka paraqitur a) "Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i inxhinierisë së ndërtimit drejtimi konstruktiv" por ka paraqitur bachelor dhe se nuk ka paraqitur c) "Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose master i inxhinierisë elektrike". Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e Ekspertit shqyrtues konstaton se kjo pikë është e paqëndrueshme dhe se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "a) një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i inxhinierisë së ndërtimit - drejtimi konstruktiv" dhe "c) një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose master i inxhinierisë elektrike i dhe kompjuterike" dhe si dëshmi është kërkuar "diploma" dhe se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar diplomën e Albert Margegaj për

inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv dhe ka ofruar diplomën e Avdyl Berisha për inxhinier të diplomuar të elektroteknikës.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur pajisje teknike sipas kërkesës së dosjes së tenderit të FTD. Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe ne sqarimet e dhëna nga Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues nuk ka qartësuar se cilën nga pajisjet nuk është ofruar dhe sqaron se në fazën e vlerësimit nga ana e AK i është kërkuar sqarime shtesë OE të rekomanduar për kontratë për disa nga pajisjet dhe OE ka ofruar brenda afatit kohor sqarimet e dhëna dhe se në ofertë është ofruar dokumenti me titull “Lista e mjeteve” nga anëtar i grupit “GËRLICA COMPANY SHPK” me gjithsej 49 mjete/pajisje për të cilat janë ofruar një sërë dokumentesh tjera përcjellëse siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –KK-Gjakovë
- 1x1 OE- “D&T Groupshpk&Horn&Co Kosova shpk& NP Inovashpk”-Gjakovë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.